



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 291/1 prot.

Shkodër, më 13.05.2022

Nr. 2546/1 Prot

Dt. 16.05.22



**LËNDA: Lidhur me vendimin Nr.28 datë 29.04.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KËSHILLIT TË BASHKISË VAU - DEJES.**



Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin” në mbështetje të , nenit 27 pika 5, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, të nenit 27, pika 5 të+ Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet” neni 25, VKB Vau-Dejës Nr.6 dat.26.01.2022 “Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në prrdorim”, Materialit të këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.2451Prot datës.5.05.2022, *Analizoi VKB Vau-Dejës nr.28 datë 29.04.2022 për ndryshim/korigjim të pikës 3 të VKB Vau-Dejës nr.19 dat.28.03.2022, mbi afatn e marrjes me qera nga 9 vjeçarë në 10 vjeçare, për dhënie në përdorim të ngastrës nr.6 dhe nr.1, me sipërfaqe 4.4 ha në ekonominë pyjore Karmë*”.

Pas trajtimit, sipas neni 112 të Kodit të Procedurave Administrative, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 28 datë 28.04.2022



**“Për Ndryshimin e vendimit nr 19 datë 28.03. 2022 per ndryshim afati te marrjes me qira nga 9-të (nëntë) vjecar në 10-të (ndhjetë) vjecar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha “Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për veprimtari turistike kampingje etj” në ekonominë pyjore karme.**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”,nenit 112 të KPAD, **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit **nr 19 datë 28.03. 2022** për dhënien në përdorim të sipërfaqes në total **4.4** ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për veprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shlodhësë etj” në **ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonominë pyjore Karmë nga 9-të (nëntë) vjecar në 10-të (ndhjetë) vjecar**,sipas listës së inventarit,**shtojca nr.47** në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

1. Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjetë) vjet.
2. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
3. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

**K R Y E T A R**  
**Mark Bisha**

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Ardian Çelepija**

Miratuar me 21 vota  
Vota Pro 20  
Vota Kunder -  
Vota Abstenim 1 (një)  
Zbardhur me datë 05.052022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

**PROJEKT V E N D I M**

Nr. 16, datë 13.04.2022

“Për ndryshimin e vendimit nr 19 datë 28.03. 2022 për ndryshim afati të marrjes me qira nga 9 (nëntë) vjekar në 10 vjekar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, në ngastrat nr.6 dhe 17 në ekonominë pyjore Karmë.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , *i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës 29.04 2022 të *Këshillit të Bashkisë* të:

**V E N D O S I**

1. Ndryshimin e vendimit **nr 19 datë 28.03. 2022** për dhënien në përdorim të sipërfaqes në total **4.4 ha** për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” në **ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonominë pyjore Karmë.**

, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

2. Afati i dhënies me qira të jetë 10 (dhjetë) vjet.

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Konceptoi: **Z. Ujka**

Konceptoi **Bazën Ligjore K. Shtatri**

Miratoi: **Rr. Ftoni**

**KRYETARI**

**MARK BABANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 27 prot.

Vau Dejës, më 15.04.2022

**RELACION**

**Për ndryshim vendimi nr 19 datë 28.03.2022.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjitnr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet“, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika e1 neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 7.

**Për arsye të procedurës së metejshme të lejës së ndertimit i propozojmë këshillit bashkiak ndryshimin e afatit të përdorimit të vendimit nr 19 datë 28.03.2022 nga 9-të (nëntë) vjetar në 10-të (dhjetë) vjetar duke mos ndryshuar sipërfaqen ,vlerën dhe funksionin .**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e vendimit.

**Specialistet**

**Ing.Mark Suli**

**Ing.Zeqir Ujka**

**Miratoi**

**Drejtori**

**Rrok Ftoni**